



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 119 Datë 22.08.2012

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SH.A NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 14, pika 1, germa “b”, si dhe të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror.” neni 4, pika 1, germa “b”; neni 5; neni 8, neni 9 pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe neni 11 dhe 12 pika 1, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, datë 11.02.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.08.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ALBPETROL” sh.a, për liçensimin në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të liçensave.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “ALBPETROL” sh.a në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror, për një afat 30 – vjeçar.
2. Shoqëria “ALBPETROL” sh.a do të paguajë tarifën e aplikimit në momentin e miratimit të saj nga ERE.

3. Shoqëria “ALBPETROL” sh.a, detyrohet të zbatojë të gjitha detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 9946, datë 30.06.2008, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kushteve të liçensës bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI